

Konkluzionet mbi njohjen reciproke të diplomave bazuar në marrëveshjen origjinale të vitit 2011

1. Duke qenë në dijeni për progresin e kufizuar që është arritur në zbatimin e Marrëveshjes së vitit 2011 mbi njohjen reciproke të diplomave, Palët u pajtuan që prapë të përpiqen dhe të ndërtojnë mbi përvojat e deritanishme me qëllim që të tejkalohen sfidat dhe të thjeshtësohen proceset.
2. Palët u pajtuan që të zbatojnë marrëveshjen për diplomat pas certifikimit nga EUA. Njohja do të ndahet në njohje profesionale dhe akademike. Njohja profesionale do të realizohet nga organet përkatëse qeveritare, brenda afatit maksimum prej 90 ditëve pas pranimit të aplikacionit dhe me një tarifë maksimum 50 euro ose ndonjë shumë ekuivalente. Njohja profesionale do të konsiderohet e pranueshme për mundësitë e punësimit, përfshirë edhe për punësimin në organet qeveritare. Njohja akademike nevojitet vetëm për vazhdimin e studimeve; procedurat do të varen nga secili institucion i arsimit të lartë veç e veç, dhe do të kenë një afat të përgjithshëm prej 5 muajsh.
3. Të gjitha certifikatat e EUA të marra më parë do të njihen nga Palët dhe diplomat e certifikuar nga EUA do të mund të dorëzohen direkt për njohje. Të gjitha njohjet e mëparshme të diplomave do të konsiderohen si të vlefshme. Partneri zbatues do t'i ofron informacionet Palëve lidhur me natyrën e kërkesës së aplikuesve (profesionale ose akademike) brenda një periudhe maksimum prej dy muajsh. Për më tepër, palët u pajtuan të shkëmbejnë të gjitha informacionet relevante për procedurat e kërkuara, përfshirë shpenzimet e tarifës, deri në fund të muajit shkurtit të vitit 2016.
4. Marrëveshja mbi diplomat dhe këto konkluzione vlejnë vetëm për institucionet dhe programet e akredituara të arsimit të lartë nga organet përkatëse të Palëve, respektivisht Beogradit dhe Prishtinës. Palët do të shkëmbejnë listën e Institucioneve të akredituara të Arsimit të Lartë, deri në fund të muajit shkurt të vitit 2016.
5. Palët u pajtuan që kjo procedurë të zbatohet tek nivelet e arsimit: Bachelor, Master dhe PhD. Palët u pajtuan gjithashtu që të njohin diplomat e arsimit fillor, të mesëm, profesional dhe nivelin e pestë të kualifikimit sipas Kornizës Evropiane të Kualifikimeve (EQF), ndërsa modalitetet e zbatimit do të diskutohen në takimin e ardhshëm.
6. Bazuar në atë që u tha më lartë, Palët u pajtuan që të fillon faza e dytë e projektit origjinal.
7. BE-ja do të krijojë një grup zbatues trepalësh deri në fund të muajit shkurt të vitit 2016, për monitorimin e zbatimit të këtyre dakordimeve dhe konkluzioneve.
8. Zbatimi i marrëveshjes mbi Njohjen Reciproke të Diplomave nga të dyja Palët do të rinis me 1 mars 2016.